

## Studim statistikor mbi besimin fetar në Shqipëri

Mbështetur nga fondacioni Konrad-Adenauer-Stiftung (KAS), Tiranë

Dhjetor 2024

---

**Autorë: Bashkim Shehu dhe Eduard Zaloshnja, PhD**

### Hyrje

Shqipëria është një rast unikal në shkallë botërore, madje në gjithë historinë e njerëzimit, si vendi në të cilin feja u ndalua me ligj përgjatë pothuajse çerek shekulli, nga viti 1967 deri më 1990. Edhe përpara kësaj periudhe, kur komunistët morën pushtetin nga fundi i vitit 1944 dhe shumë shpejt instaluan diktaturën, feja në Shqipëri u ndodh nën një trysni të vazhdueshme e të shumanshme, qoftë nëpërmjet propagandës së një ateizmi politikisht militant, qoftë nëpërmjet ndërhyrjes shtetërore në institucionet fetare, qoftë nëpërmjet burgosjesh apo ekzekutimesh të klerikëve.

Mbyllja e këtyre institucioneve dhe ndalimi i fesë më 1967 shënon fillimin e një faze të re të totalitarizmit shqiptar. Historikisht, siç dihet, liria e opinionit si e drejtë e njeriut e ka zanafillën te liria fetare në disa vende të Europës Perëndimore në shekullin XVII, pra te mosndërhyrja e autoriteteve shtetërore në një sferë kaq thellësisht vetjake siç është ajo e besimit fetar. Kësisoj, çka është veçanërisht e rëndësishme dhe që nuk është theksuar sa duhet, ndalimi i fesë në Shqipëri përbente një tkurrje të skajshme të autonomisë individuale, një përpjekje për të thelluar kontrollin totalitar në ndërgjegjjet e njerëzve, përfshirë, tërthorazi, edhe ata që nuk besonin. Te kjo luftë kundër fesë, në mënyrë më të qartë se në çdo fushë tjetër të jetës së vendit, shfaqet ndërthurja e terrorit dhe e propagandës ideologjike, ndërthurje që përbën pikërisht thelbin e kontrollit totalitar siç e shpjegon

Hannah Arendt. Mund të themi se kjo përgatiti objektivisht një terren të përshtatshëm për një nga kapitujt më të errët në historinë e diktaturës komuniste në Shqipëri: vala represive e viteve shtatëdhjetë, përgjatë së cilës, paralelisht, kulti i diktatorit u lartësua deri në paroksisëm.

Me ndalimin e fesë, Shqipëria u shpall shtet ateist, gjë që u sanksionua edhe në kushtetutën e vendit. Përgjatë asaj periudhe, jo vetëm që u ndalua ushtrimi i kulteve fetare, po edhe thjesht shprehja e besimit fetar konsiderohej krim kundër shtetit, parashikuar posaçërisht në një dispozitë të kodit penal të dallueshme nga neni për “agjitacion e propagandë kundër shtetit”, por me të njëjtën shkallë penalizimi, domethënë tre deri në dhjetë vjet burg.

Është jo pak domethënës fakti që dekompozimi i totalitarizmi në Shqipëri solli dekriminalizimin e fesë dhe restaurimin e lirisë fetare.

Të tria këto faza që u përmendën gjejnë pasqyrim në strukturën aktuale demografike të vendit. Kështu, brezi që e ka përjetuar periudhën para se feja të ndalohej përbën 27.2% të banorëve në moshë madhore; brezi që u formua gjatë periudhës së ateizmit shtetëror përbën 40.1% të banorëve në moshë madhore; dhe brezi që u formua mbas rikthimit të lirisë së besimit përbën 32.7% të banorëve në moshë madhore. Në censin e fundit në Shqipëri, të kryer nga agjencia shtetërore INSTAT (CENS-23), 45.9% e të anketuarve u vetëdeklaruan si myslimanë sunitë, 8.4% si të krishterë katolikë, 7.2% si të krishterë ortodoksë, 4.8% si bektashinj, 3.5% si ateistë, etj. Ndërkaq, një përqindje shumë e lartë e të anketuarve në këtë cens (13.8%) nuk e deklaruan besimin e tyre fetar, 10.2% refuzuan të përgjigjeshin dhe 5.6% nuk ishin të disponueshëm – pra, gjithsej, pothuaj 30% rezultuan të pidentifikuar në lidhje me besimin fetar.

Në studimin tonë statistikor me intervistim ballë për ballë në terren, kemi synuar të hulumtojmë më thellë se INSTAT-i. Qëllimi që i vumë vetes nuk ishte thjesht matja e përqindjeve të vetidentifikimit në lidhje me fenë, por të kuptuarit e thellësisë së besimit fetar

(në rastet ku ekziston) dhe të impaktit të periudhës së lartpërmendur të ateizmit shtetëror në këtë aspekt, për çka kemi kryer një anketë prej pothuajse 60 pyetjesh me 820 persona në moshë madhore. Bateria e plotë të përgjigjeve dhe marzhin e gabimit statistikor për secilën përgjigje mund ta gjeni në Aneksin 1. Ndërsa metodologjinë e përdorur në këtë vrojtim statistikor mund ta gjeni në Aneksin 2.

## Rezultatet kryesore

- 59% e të anketuarve deklaruan se, bazuar në bindjet personale (pavarësisht nga prejardhja familjare), besojnë plotësisht në ndonjë fe të caktuar. Ndërkaq, 56% e të anketuarve besojnë në fenë e origjinës familjare.
- 21.7% e të anketuarve deklaruan se shkojnë *të paktën* një herë në muaj në kishë/xhami/teqe/etj.
- Vetëm 6.8% e të anketuarve mund të konsiderohen thellësisht besimtarë të fesë që deklarojnë se besojnë, përcaktuar nga përgjigjet pozitive për të gjitha këto pyetje: shkojnë të paktën një herë në javë në kishë/xhami/teqe/etj.; mendojnë se gjërat në botë ndodhin nga vullneti i Zotit; mendojnë se njeriu është krijesë e Zotit; mendojnë se, me vdekjen e njeriut, shpirti i tij vazhdon të jetojë në botën e përtejme; mendojnë se, në varësi të të mirave apo të këqijave që bën njeriu në jetë, shpirti i tij mund të shkojë në Parajsë ose në Ferr.
- Të anketuarit që rregullisht agjërojnë/mbajnë kreshmë përbëjnë 22.2% të numrit të përgjithshëm.
- Brezi i vjetër (65 vjeç e sipër), i cili e ka përjetuar periudhën para se të ndalohej feja, ka përqindjen më të lartë të atyre që shkojnë *të paktën* një herë në muaj në kishë/xhami/teqe/etj. (23.5%), ndërsa brezi i mesmë (40-64 vjeç), i cili u formua gjatë asaj periudhe, ka përqindjen më të ulët (19%).
- Pothuaj gjysma e atyre që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar shkojnë, megjithatë, në kishë/xhami/teqe/etj. me shpresën se një gjë e tillë mund t'i ndihmojë për problemet e tyre jetësore/shëndetësore, dhe mbi gjysma e jo-fetarëve që shkojnë në

kishë/xhami/teqe/etj. deklarojnë se ekzistojnë raste kur kjo i ka ndihmuar ata ose të njohur të tyre.

- Pothuaj 40% e të anketuarve kanë kryer ose dinë që prindërit apo gjyshërit e tyre kanë vazhduar të kryejnë fshehurazi rite fetare në periudhën kur kjo dënohej penalisht.
- 79% e të anketuarve deklaruan se nuk e kanë problem që një pjesëtar i familjes (përfshirë dhe veten) të martohet apo të bashkëjetojë me dikë nga një familje me prejardhje fetare të ndryshme; një martesë/bashkëjetesë të tillë kanë realisht 21.5% e të anketuarve të martuar/bashkëjetues.
- Vetëm 75% e të anketuarve kanë të njëjtin besim fetar (ose, përkatësisht, nuk besojnë) sikurse baballarët e tyre dhe 72% sikurse nënat e tyre. Ndër të martuarit/bashkëjetuesit, vetëm 69% kanë të njëjtin besim fetar (ose, përkatësisht, nuk besojnë) sikurse bashkëshortët/bashkëjetuesit e tyre.
- Gjasat e dikujt me nënë që beson/te në ndonjë fe të caktuar janë 6.27 herë më të mëdha se të dikujt me nënë që nuk beson/te në asnjë fe të caktuar, kur të gjitha karakteristikat e tjera i kanë të njëjta. Në rastin e babait, ky koeficient është më i ulët: 4.2.

## Konkluzionet kryesore

- Besimi fetar vazhdon të jetë mjaft i përhapur në Shqipëri, me një përqindje besimtarësh përafërsisht sa ajo e Europës Perëndimore (shihni “Përmbledhjen”, në fund të kapitullit “Rezultate të detajuara”).
- Numri i atyre që mund të konsiderohen thellësisht besimtarë është relativisht i vogël, krahasuar me numrin e përgjithshëm të besimtarëve, gjë që vërehet sot edhe në ndonjë vend me histori diametralisht të kundërt në raportin e shtetit me fenë.
- Ateizmi shtetëror jo vetëm që nuk e arriti qëllimin e çrrënjësjes së fesë, po edhe nuk solli ndonjë ndryshim të madh në këtë drejtim. Besimi fetar, me sa duket, është një nga shtresat më refraktare të botës së brendshme të njeriut përballë dhunës politike.

## REZULTATE TË DETAJUARA

Plot 41% e të anketuarve deklaruan se, bazuar në bindjet personale (pavarësisht nga prejardhja fetare familjare), nuk besojnë në asnjë fe të caktuar, *i. e.* të institucionalizuar – 33.8% besojnë në ekzistencën e Zotit, por jo në ndonjë fe të caktuar, dhe 7.2% deklarohen ateistë/agnostikë. Të tjerët deklaruan se besojnë në një fe të caktuar apo në një tjetër, siç mund të shihet në tabelën këtu poshtë. Ndërkaq, me besim fetar kuptohet, së pari, pikërisht besimi i institucionalizuar; dhe, së dyti, sipas përkufizimit nga filozofi Leszek Kolakowski, përkatësia shpirtërore e individit në një komunitet besimtarësh. Nga ana tjetër, besimi në ekzistencën e Zotit, por jo në ndonjë fe të caktuar, mund të jetë ose deizëm filozofik, ose, më shpesh, njëfarë deizmi popullor në trajtën e një ideje të vagullt për ekzistencën e një qenieje të mbinatyrshme.

1. Bazuar vetëm në bindjet tuaja personale (pavarësisht nga prejardhja fetare familjare), a besoni plotësisht në ndonjë fe të caktuar?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Besoj në Zot, por jo në ndonjë fe	33.8	2.3
2. Ateist/agnostik	7.2	0.5
3. Tarikati bektashi	5.2	0.4
4. Tarikati rufai/halveti/tjetër	0.5	0.0
5. Dega kryesore myslimane (sunitë)	36.0	2.4
6. I krishterë katolik	7.9	0.5
7. I krishterë ortodoks	8.0	0.5
8. I krishterë protestant/tjetër	1.3	0.1

Nga tabela e mëposhtme del se besimi në një fe të caktuar është më i pranishëm në brezin e vjetër, ndërsa te brezi i ri është vetëm pak më shumë i pranishëm se te brezi i mesmë.

Është për t'u vënë re se te katolikët, përkundrazi, përqindja më e lartë e besimtarëve është ajo e brezit të mesmë, domethënë pikërisht e atij brezi që është formuar në kohën e ateizmit të detyruar, dukuri që mund të shpjegohet si shprehje rezistence ndaj shtetit: është një përqindje pak a shumë e barabartë me të vitit 1938 (shihni më tej tabelën 6). Ndërkaq, te myslimanët sunitë, përqindja e brezit më të ri është më e madhja, me një diferencë të theksuar nga ajo e brezit të mesmë, çka është po ashtu një përjashtim nga tabloja e përgjithshme e paraqitur në tabelën këtu poshtë.

2. Bazuar vetëm në bindjet tuaja personale (pavarësisht nga prejardhja fetare familjare), a besoni plotësisht në ndonjë fe të caktuar?	18-39 vjeç	40-64 vjeç	65+
	%	%	%
1. Besoj në Zot, por jo në ndonjë fe	34.4	36.2	29.6
2. Ateist/agnostik	7.1	7.4	5.3
3. Tarikati bektashi	4.3	4.6	7.2
4. Tarikati rufai/halveti/tjetër	0.8	0.0	0.9
5. Dega kryesore myslimane (sunitë)	36.9	32.4	42.2
6. I krishterë katolik	7.0	10.4	5.3
7. I krishterë ortodoks	7.8	7.2	9.6
8. I krishterë protestant/tjetër	1.7	1.8	0.0
GJITHSEJ	100.0	100.0	100.0

Vendet e kultit janë hapësirë e institucionalizuar dhe hapësirë komunitare e fesë (çka përputhet me konceptin e lartpërmendur të besimit fetar). Nga tabela e mëposhtme del se përqindja e atyre që i frekuentojnë rregullisht këto hapësira është shumë më e ulët se përqindja e atyre që deklarohen besimtarë të një feje të caktuar.

3. Sa shpesh veni në xhami/kishë/teqe/tjetër?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Çdo javë	11.2	0.8
2. Çdo 2 javë	2.5	0.2
3. Çdo muaj	8.0	0.5
4. Më rrallë	22.1	1.5
5. Vetëm për festa fetare	26.7	1.8
6. Vetëm kur kam ndonjë problem shëndetësor/jetësor	4.1	0.3
7. Nuk shkoj fare	25.4	1.7

Nga të tria grupmoshat, përqindja më e madhe e frekuentuesve të rregullt të vendeve të kultit është ajo e brezit më të vjetër. Ndërkaq, brezi i mesëm ka një përqindje frekuentuesish shumë të rregullt (një herë në javë) më të lartë se ajo e brezit të ri, por një përqindje më të ulët frekuentuesish jo dhe aq të rregullt. Veç asaj, është interesant fakti se individët nga grupmosha e brezit të ri janë ata që frekuentojnë më shumë vendet e kultit në raste festash fetare, ndërsa, njëkohësisht, kanë përqindje më të ulët se dy grupmoshat e tjera në kategorinë e atyre që nuk shkojnë fare në vendet e kultit.

4. Sa shpesh veni në xhami/kishë/teqe/tjetër?	18-39 vjeç	40-64 vjeç	65+
	%	%	%
1. Çdo javë	9.4	10.7	14.1
2. Çdo 2 javë	4.2	2.0	1.1
3. Çdo muaj	9.9	6.3	8.3

4. Më rrallë	23.2	22.6	20.0
5. Vetëm për festa fetare	28.8	25.9	25.5
6. Vetëm kur kam ndonjë problem shëndetësor/jetësor	4.7	3.1	5.1
7. Nuk shkoj fare	19.9	29.4	26.0
GJITHSEJ	100.0	100.0	100.0

Për arsye historike të vetëkuptueshme, tabela e mëposhtme, e cila pasqyron përqindjet e besimit fetar vetëm sipas origjinës familjare, nuk përmban të dhëna për kategorinë e deistëve dhe kategorinë e ateistëve/agnostikëve: në një të kaluar jo të largët, paraardhësit e gjithsecilit, ose pothuaj të gjithsecilit, i përkisnin një komuniteti fetar apo një tjetri.

5. Pavarësisht nëse besoni apo nuk besoni realisht në ndonjë fe të caktuar, po të bazoheni vetëm në origjinën tuaj familjare, cilës fe i përkisni?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Tarikati bektashi	12.6	0.8
2. Tarikati rufai/halveti/tjetër	0.6	0.0
3. Dega kryesore myslimane (sunitë)	60.9	2.7
4. I krishterë katolik	11.5	0.8
5. I krishterë ortodoks	14.3	1.0
6. Tjetër	0.1	0.0
GJITHSEJ	100.0	



Në një vështrim krahasues diakronik të përkatësisë fetare bazuar *vetëm* në origjinën familjare, del se përqindja e pjesëtarëve të familjeve historikisht ortodokse është më e ulët se në vitin 1938 – një rënie e theksuar, nga 20% në 14.3%. Një faktor që e shpjegon këtë dukuri është lindshmëria: mesatarja e numrit të pjesëtarëve të familjeve historikisht ortodokse na del 3.5, përkundrajt 4.3 i familjeve të tjera. Një faktor tjetër, hipotetik, është ai që lidhet me eksodin e vazhdueshëm që prej vitit 1991 (nga 4.63 milionë shtetas shqiptarë që figurojnë sot në Regjistrin e Gjendjes Civile, vetëm 2.4 milionë banojnë aktualisht në Shqipëri sipas CENS-23 të agjencisë shtetërore INSTAT). Nisur nga raportet e shumta të mediave rreth shpopullimit të fshatrave jugorë, mund të thuhet se familjet historikisht ortodokse kanë emigruar më shumë se të tjerat. (Për këtë tabelë, duhet sqaruar se, në censin e vitit 1938, nuk është bërë një ndarje dalluese mes degëve të ndryshme të fesë myslimane dhe nuk figuron përqindja e ateistëve/agonstikëve, numri i të cilëve ka qenë i papërfillshëm. Për efekt krahasimi, po kështu kemi vepruar në paraqitjen e gjendjes aktuale në tabelën e mëposhtme.)

6. Përkatësia fetare bazuar <i>vetëm</i> në origjinën familjare	1938	2024
Myslimanë (sunitë/bektashinj/rufainj/halvetinj/ tjetër)	70%	74.1%
Të krishterë ortodoksë	20%	14.3%
Të krishterë katolikë	10%	11.5%
Tjetër	-	0.1%

Lidhur me tabelën e mëposhtme, vëmë në dukje se rastet e martesës apo të bashkëjetesës me persona nga e njëjta fe e origjinës familjare përbëjnë mbi 3/4 e numrit të personave të martuar apo që bashkëjetojnë me një person tjetër.

7.Martesë/bashkjetesë	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
Me origjinë të njëjtë fetare familjare	78.4	1.5
Me origjinë të ndryshme fetare familjare	21.6	1.5

Në tabelat që vijojnë paraqiten *vetëm* rezultate ku dallohet me shikim të shpejtë një diferencë midis përgjigjeve të besimtarëve të ndonjë feje të caktuar dhe përgjigjeve të të tjerëve (deistëve/ateistëve/agnostikëve). Konkretisht, në tabelën e mëposhtme duken qartazi diferencat nga brezi në brez. Kështu, te brezi më i moshuar, përqindja e besimtarëve në një fe të caktuar është më e lartë se ajo e të tjerëve; te brezi i mesmë domethënë, te brezi i edukuar gjatë periudhës së ateizmit shtetëror, është më e ulët se e të tjerëve; ndërsa te brezi më i ri është vetëm paksa më e ulët se ajo e të tjerëve.

8. Sa vjeç jeni?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. 18–39 vjeç	32.1	33.5
2. 40–64 vjeç	38.0	43.1
3. 65 vjeç e sipër	29.9	23.4
	100.0	100.0

Ndër banorët e zonave rurale, përqindja e besimtarëve është më e lartë se ajo e atyre që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar. Ndër banorët e zonave urbane kemi dukurinë e anasjelltë.

9. Zona ku u krye intervista:	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Urbane	62.8	70.2
2. Rurale	37.2	29.8
	100.0	100.0

Ndër të anketuarit e lindur në zona rurale, përqindja e besimtarëve është më e lartë se ajo e atyre që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar. Ndër të anketuarit e lindur në zonat urbane vërejmë dukurinë e anasjelltë. (Duhet pasur parasysh se në dekadat e fundit ka pasur zhvendosje të rëndësishme popullore nga fshati në qytet, dhe së këtejmi vjen dallimi i tabelës mëposhtme nga e mësipërmja).

10. Ku keni lindur?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Qytet	52.6	62.3
2. Fshat	47.5	37.7

	100.0	100.0

Në mënyrë analoge, kjo diferencë vërehet edhe në raport me vendlindjen e babait, figura e autoritetit në familjet shqiptare tradicionalisht dhe aktualisht.

11. Ku ka lindur babai juaj?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Qytet	31.0	34.4
2. Fshat	69.0	65.6
	100.0	100.0

Në mënyrë analoge, kjo diferencë vërehet edhe në raport me vendlindjen e bashkëshortit/ bashkëshortes, ose bashkëjetuesit/ bashkëjetueses, si rregull njeriu më intimisht i afërt.

12. Ku ka lindur bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja juaj?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Qytet	35.5	45.2
2. Fshat	43.1	34.5

3. Nuk jam i/e martuar dhe as bashkëjetoj	21.5	20.3
	100.0	100.0

Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar kanë një nivel relativisht të ulët arsimor: vetëm 28.8% e tyre kanë arsim të lartë (universitar ose pasuniversitar), kundrejt 39.3% me arsim të lartë ndër ata që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar. Nga ana tjetër, ndër të anketuarit me nivel arsimor të mesëm, përqindja e është më e madhe se ajo e atyre që nuk besojnë, madje diferenca është mjaft e theksuar, çka përbën një kontrast ndaj dukurisë së lartpërmendur në lidhje me arsimin e lartë.

13. Cili është niveli juaj arsimor?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Pa shkollë	1.1	0.4
2. Më pak se shkolla e mesme	33.0	30.2
3. Shkollë e mesme	37.1	30.2
4. Arsim universitar	19.2	28.3
5. Arsim pasuniversitar	9.6	11.0
	100.0	100.0

Të njëjtat dukuri vërehen edhe në lidhje me nivelin arsimor të bashkëshortit/bashkëshortes, ose të bashkëjetuesit/bashkëjetueses.

14. Cili është niveli arsimor i bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es suaj?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Pa shkollë	0.4	0.7
2. Më pak se shkolla e mesme	25.0	21.7
3. Shkollë e mesme	34.5	29.0
4. Arsim universitar	15.2	19.8
5. Arsim pasuniversitar	4.3	7.3
6. Nuk jam i/e martuar dhe as bashkëjetoj	20.7	21.5
	100.0	100.0

Vëmë në dukje se, ndër të anketuarit me arsim fetar, është relativisht e konsiderueshme përqindja e atyre që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar kundrejt përqindjes së atyre që besojnë.

15. A keni arsim fetar?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar

	%	%
1. Jo	97.2	99.2
2. Po, në Shqipëri	2.6	0.5
3. Po, në Turqi	0.1	0.3
4. Po, në Arabi	0.1	
5. Po, diku tjetër		
	100.0	100.0

Besimi në një fe të caktuar është më i pranishëm ndër të anketuarit me baba punonjës të pakualifikuar, veçanërisht punëtor bujqësie, si dhe ndër të anketuarit me baba pensionist, dukuri që përforcojnë ato që vërejmë në tabelat e mësipërme, përkatësisht në lidhje me nivelin arsimor, me vendlindjen dhe me grupmoshat. Nga ana tjetër, në lidhje me raportin ndërmjet fesë dhe shkollës përgjithësisht si vatër e laicitetit iluminist, vëmë në dukje se besimi në një fe të caktuar është shumë pak i pranishëm ndër të anketuarit me babain në arsim/shëndetësi.

16. Çfarë pune bën ose ka bërë babai juaj?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Punëtor i thjeshtë jo bujqësor	35.9	24.3
2. Bujqësi	24.1	6.1
3. Nëpunës shteti	11.8	21.7
4. I vetëpunësuar	6.3	15.8

5. Teknik/inxhinier	8.2	8.8
6. Arsim/shëndetësi	1.7	18.7
7. Menaxher	0.4	2.6
8. Pensionist	10.9	2.0
9. Duke kërkuar punë	0.5	
10. Në shtëpi	0.1	
	100.0	100.0

Në mënyrë analoge me tabelën për nivelin arsimor, tabela e mëposhtme tregon se përqindja e atyre që besojnë në ndonjë fe të caktuar është më e madhe ndër të anketuarit me paga të ulta dhe të mesme (të ardhura mujore familjare deri në 1000 Euro).

17. Sa janë afërsisht të ardhurat mujore të familjes suaj?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Deri 300 Euro	8.7	10.0
2. Nga 300-500 Euro	22.3	16.2
3. Nga 500-750 Euro	18.1	17.6
4. Nga 750-999 Euro	27.5	23.1
5. Nga 1000-1500 Euro	17.9	18.2
6. Mbi 1500 Euro	5.5	14.2
7. (REFUZON)		0.7



	100.0	100.0
--	-------	-------

Siç del nga tabela e mëposhtme, sa më i madh numri i personave që jetojnë larg familjes, aq më e madhe është diferenca përpjesëtimore e atyre që besojnë në ndonjë fe të caktuar kundrejt atyre që nuk besojnë. (Me gjasë, largimi nga familja ndodh më së shumti për shkaqe ekonomike: kjo diferencë i përgjigjet asaj të tabelës së mësipërme në lidhje me shtresëzimin sipas të ardhurave).

18. Sa pjesëtarë të familjes banojnë në rrethe të tjera ose jashtë vendit?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Asnjë	38.5	48.4
2. Një-dy	38.1	35.5
3. Tre-katër	11.5	9.7
4. Pesë-gjashtë	6.9	3.8
5. Mbi gjashtë	4.9	2.6
	100.0	100.0

Besimi instrumental, domethënë një akt besimi si *mjet* për të arritur diçka në jetën tokësore, është më i pranishëm ndër të anketuarit që besojnë në ndonjë fe të caktuar sesa tek ata që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar. Nga ana tjetër, edhe te këta është mjaft i pranishëm dhe është qartazi besëtytni.

19. A mendoni se vajtja në kishë/xhami/teqe/tyrbe etj. mund t'i ndihmojë ata që shkojnë atje për zgjidhjen e problemeve të tyre shëndetësore/jetësore?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Po	72.1	32.4
2. Jo	16.2	39.6
3. Jam i/e dyzuar	11.7	28.0
	100.0	100.0

Në tabelën e mëposhtme vërehen të njëjtat diferenca në lidhje me besimin instrumental. Nga ana tjetër, ndër të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar, përqindja e atyre që kanë shkuar në vende të kultit ose në vende të tjera të shenjta për të kërkuar ndihmën hyjnore është më e madhe se përqindja e tyre në tabelën e mësipërme, domethënë, e atyre që nuk mendojnë se do ta gjenin ndihmën hyjnore.

20. A keni shkuar ju vetë në kishë/xhami/teqe/tyrbe etj. me shpresën që vajtja atje mund t'ju ndihmonte për zgjidhjen e problemeve tuaja shëndetësore/jetësore?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Po	77.0	45.0
2. Jo	22.6	54.9

3. (REFUZON)	0.4	0.1
	100.0	100.0

Në tabelën e mëposhtme vërehen të njëjtat diferenca në lidhje me besimin instrumental sikurse në dy tabelat e mësipërme. Kjo tabelë, sikurse dy tabelat e mësipërme, tregojnë se vajtja në vende të kultit për të kërkuar ndihmën hyjnore është, me çdo gjasë, e motivuar në mënyrë të konsiderueshme nga besimi instrumental.

21. A dini ndonjë rast që vajtja juaj apo e familjarëve/të njohurve tuaj në kishë/xhami/teqe/tyrbe etj. të ketë sjellë zgjidhje problemesh konkrete shëndetësorë/jetësore?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Po	66.1	25.1
2. Jo	24.8	57.7
3. Jam i/e dyzuar	9.1	17.3
	100.0	100.0

Ndër treguesit e tabelës së mëposhtme është veçanërisht interesante dukuria se një pjesë e mirë e atyre që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar, ose prindërit/gjyshërit e tyre, kanë kryer fshehtazi rite fetare edhe kur kjo ishte e ndaluar me ligj.

22. A keni vazhduar ju ose prindërit/gjyshërit tuaj t'i kryeni ritet fetare fshehurazi gjatë periudhës që feja ishte e ndaluar në Shqipëri?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Po	47.3	26.1
2. Jo	42.3	63.3
3. Nuk e di	10.5	10.6
	100.0	100.0

Vërejmë se, edhe ndër familjet e të anketuarve që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar, përqindja e atyre që kremtojnë familjarisht festat fetare zyrtare është e lartë.

23. A shtroni dreka/darka në familje për festat e mëdha fetare të traditës suaj familjare?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Rregullisht	79.8	50.3
2. Herë-herë	18.3	38.5
3. Jo	1.9	11.3
	100.0	100.0

Përqindja e besimtarëve në ndonjë fe të caktuar është përgjithësisht më e madhe në rastet që edhe babai i të anketuarit është/ka qenë besimtar i tillë.

24. Bazuar vetëm në bindjet e tij personale (pavarësisht nga prejardhja familjare), a beson/te plotësisht babai juaj në ndonjë fe të caktuar?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Beson/te në Zot, por jo në ndonjë fe	8.3	61.1
2. Ateist/agnostik	1.4	9.0
3. Tarikati bektashi	9.4	4.4
4. Tarikati rufai/halveti/tjetër	0.7	0.2
5. Dega kryesore myslimane (sunit)	54.5	16.1
6. I krishterë katolik	12.4	2.6
7. I krishterë ortodoks	12.5	5.2
8. I krishterë protestant/tjetër	0.5	
9. Nuk e di	0.3	1.5
	100.0	100.0

Përqindja e besimtarëve në ndonjë fe të caktuar është më e lartë në rastet që edhe nëna e të anketuarit është/ka qenë besimtare e tillë.

25. Bazuar vetëm në bindjet e saj personale (pavarësisht nga prejardhja familjare), a beson/te plotësisht nëna juaj në ndonjë fe të caktuar?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Beson/te në Zot, por jo në ndonjë fe	5.5	57.8
2. Ateiste/agnostike	0.5	4.2
3. Tarikati bektashi	8.9	4.4
4. Tarikati rufai/halveti/tjetër	2.0	0.6
5. Dega kryesore myslimane (sunite)	58.2	23.1
6. E krishterë katolike	12.1	3.3
7. E krishterë ortodokse	12.1	5.7
8. E krishterë protestante/tjetër	0.6	
9. Nuk e di	0.2	0.9
	100.0	100.0

Përqindja e besimtarëve në ndonjë fe të caktuar është më e lartë në rastet që edhe bashkëshorti/bashkëshortja apo bashkëjetuesi/bashkëjetuesja i personit të anketuar është ose ka qenë besimtar/besimtare gjithashtu.

26. Bazuar vetëm në bindjet e tij/e saj personale (pavarësisht nga prejardhja familjare), a beson/te plotësisht bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja juaj në ndonjë fe të caktuar?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar

	%	%
1. Beson/te në Zot, por jo në ndonjë fe	7.7	45.0
2. Ateist/agnostik	0.8	9.6
3. Tarikati bektashi	7.4	2.0
4. Tarikati rufai/halveti/tjetër	0.5	
5. Dega kryesore myslimane (sunitë)	44.6	16.2
6. I/e krishterë katolik/e	9.1	2.8
7. I/e krishterë ortodoks/e	8.6	4.2
8. I/e krishterë protestant/e; tjetër	1.3	
9. Nuk jam i/e martuar as bashkëjetoj	20.2	20.3
	100.0	100.0

Duke pasur parasysh se leximi i librave në përgjithësi është një shprehje pak e pranishme në shoqërinë shqiptare aktualisht, vërejmë se përqindja e atyre që deklarojnë se lexojnë libra të shenjtë është relativisht mjaft e madhe, madje edhe ndër ata që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar.

27. A lexoni/keni lexuar libra të shenjtë, si Bibla, Kurani, etj.?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Shpesh	24.5	7.8
2. Rrallë	45.1	27.1
3. Jo	30.4	65.2

	100.0	100.0

Përqindja e atyre që kanë mendim negativ për ndalimin e fesë në Shqipëri është mjaft e madhe. Ndër ata që besojnë në një fe të caktuar është ndjeshëm më e madhe se te të tjerët.

28. Si mendoni, a ka ndikuar për mirë apo për keq në shoqërinë shqiptare ndalimi ligjërisht i feve nga shteti shqiptar në periudhën 1967-1990?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Për mirë	0.4	15.7
2. Për keq	77.9	42.1
3. Jam i/e dyzuar	11.5	25.2
4. Nuk kam njohuri të mjaftueshme	10.2	17.1
	100.0	100.0

Shumica dërrmuese e të anketuarve nuk e kanë problem lidhjen martesore ose krushqinë me persona të një feje të ndryshme nga e vetja. Ndër besimtarët e ndonjë feje të caktuar, përqindja e atyre që nuk e kanë problem është vetëm paksa më e lartë se ndër të tjerët.



29. A e keni problem nëse një pjesëtar i familjes tuaj (përfshirë veten) martohet me dikë nga një familje me prejardhje fetare të ndryshme nga juaja (p.sh. martesë mysliman/e me të krishterë)?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Po	14.9	8.9
2. Jo	75.1	85.3
3. Jam i/e dyzuar	10.0	5.9
	100.0	100.0

Përqindja e të anketuarve nga familje në pozita të mira gjatë komunizmit është shumë më e lartë ndër ata që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar, ndërsa të anketuarit nga familje të përndjekura janë pothuaj dy herë më shumë ndër besimtarët e ndonjë feje të caktuar se ndër të tjerët.

30. Si ka qenë situata politike e familjes suaj para vitit 1990?	Të anketuarit që besojnë në një fe të caktuar	Të anketuarit që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar
	%	%
1. Në pozita të mira	25.5	40.8
2. As mirë, as keq	54.3	46.2
3. E përndjekur	19.1	11.0
4. Nuk e di	1.1	2.0

	100.0	100.0

\*\*\*

Nga analiza simultane e korelacionit statistikor (të realizuar nëpërmjet një modeli regresioni logaritmik), del se gjasat e besimit në një fe të caktuar janë pothuaj 21.6 herë më të mëdha tek ata me arsim fetar (shihni tabelën më poshtë). Gjasat përlllogariten sipas modelit statistikor duke faktorizuar njëherësh të gjithë faktorët e tjerë. Domethënë, modeli tregon se një i anketuar me arsim fetar i ka gjasat pothuaj 21.6 më të mëdha se një i anketuar pa arsim fetar dhe me të njëjtat karakteristika demografike-arsimore-ekonomike-fetare-politike.

Ndërkaq, arsimi fetar nuk mund të konsiderohet faktor sociologjikisht i rëndësishëm i pranisë së besimit në ndonjë fe të caktuar: personat me arsim fetar përbëjnë një pjesë shumë të vogël të shoqërisë shqiptare dhe, për më tepër, ata që shkojnë në një shkollë fetare janë shpeshherë besimtarë qysh përpara se të shkojnë. Prandaj, për sa i përket rëndësisë së faktorëve nga pikëpamja sociologjike, le të shohim ata që kanë një shtrirje më të gjerë në shoqëri.

Më i rëndësishmi prej tyre nga kjo pikëpamje është besimi fetar i nënës: gjasat e dikujt me nënë që beson/te në ndonjë fe të caktuar janë 6.27 herë më të mëdha se të dikujt me nënë që nuk beson/te në asnjë fe të caktuar, nëse të gjitha karakteristikat e tjera i kanë të njëjta. Thuajse po aq i rëndësishëm është korrelacioni me besimin e bashkëshortit/bashkëshortes (ose të bashkëjetuesit/bashkëjetueses) në ndonjë fe të caktuar: koeficienti i gjasave është 6.26. Në këtë rast, shpjegimi është se besimi fetar i personit ndikon që ai ose ajo të zgjedhë ose të pranojë një bashkëshort/bashkëshorte (ose bashkëjetues/bashkëjetuese) që është gjithashtu besimtar/e. Veç asaj, duhet të kemi parasysh se, ngaqë më se një e treta e popullsisë janë banorë të zonave rurale, domethënë

banorë zonash kryesisht homogjene nga pikëpamja e përkatësisë fetare, mundësia e zgjedhjes së bashkëshortit/bashkëshortes është ndjeshëm më e vogël, çka do të thotë se ky përkim i përkatësisë fetare është në një masë të konsiderueshme rrjedhojë e një rrethane të rastësishme, siç është lindja në një zonë të caktuar apo në një tjetër. Ndërsa në rastin e besimit të babait në ndonjë fe të caktuar koeficienti është 4.2. Edhe kjo përbën një faktor të rëndësishëm ndikimi, po të kemi parasysh autoritetin e babait në familjen shqiptare tradicionalisht dhe aktualisht, si dhe diferencën statistikore ndërmjet të anketuarve sipas tabelës 40.

Faktorët e tjerë kanë ndikim statistikor më të moderuar. Kështu, nëse nëna e një personi nuk është punonjëse e kualifikuar (teknike/inxhinierë, menaxhere, punonjëse arsimit/shëndetësie, nëpunëse shteti), gjasat e këtij personi për të besuar në ndonjë fe të caktuar janë 2.05 herë më të mëdha. Nëse nëna nuk ka pasur arsim të lartë, gjasat e një personi për të besuar në ndonjë fe të caktuar janë 10% më të mëdha se të një tjetri me të njëjtat karakteristika demografike-arsimore-ekonomike-fetare-politike, përveç arsimit të nënës.

Nëse bashkëshorti/bashkëshortja (ose bashkëjetuesi/bashkëjetuesja) e një personi ka lindur në zonë rurale, gjasat e tij për të besuar në një fe të caktuar janë 11% më të mëdha se të dikujt me të njëjtat karakteristika demografike-arsimore-ekonomike-fetare-politike me të, përveç vendlindjes së bashkëshortit/bashkëshortes (bashkëjetuesit/bashkëjetueses), dhe 7% më të mëdha nëse ai person nuk është punonjës i kualifikuar.

Një faktor me ndikim të ndjeshëm statistikor është edhe gjinia: gratë kanë gjasa 76% më të mëdha të besojnë në ndonjë fe të caktuar, nëse të gjithë faktorët e tjerë janë të njëjtë. Edhe faktori arsimor ka ndikim të ndjeshëm: një person pa arsim të lartë ka 50% më shumë gjasa që të besojë në ndonjë fe të caktuar, nëse të gjithë faktorët e tjerë janë të njëjtë. Një përqindje mjaft e përafërt gjasash (36%) vërehet ndër personat me të ardhura familjare nën 1000 Euro në muaj.

Datëlindja dhe vendlindja janë gjithashtu faktorë me ndikim në gjasat e besimit në ndonjë fe të caktuar. Kështu, gjasat e atyre që kanë lindur para vitit 1960 janë 9% më të

mëdha, ndërsa te brezi më i ri (18 – 39 vjeç) gjasat janë 6% më të mëdha. Për sa i përket vendlindjes, ndër ata që kanë lindur në fshat, gjasat e besimit në ndonjë fe të caktuar janë 17% më të mëdha se ndër ata që ka lindur në qytet (kur të gjitha karakteristikat e tjera demografike-arsimore-ekonomike-fetare-politike janë të njëjta).

Në martesat (ose në bashkëjetesë) ndërmjet personave me të njëjtën origjinë fetare gjasat e besimit në ndonjë fe të caktuar janë 43% më të mëdha se të personave të tjerë (kur të gjitha karakteristikat e tjera demografike-arsimore-ekonomike-fetare-politike janë të njëjta).

Faktorë të tjerë demografikë-arsimorë-fetarë-ekonomikë-politikë të të anketuarve – sikurse babai punonjës jo i kualifikuar, vendbanimi rural, përndjekja e familjes nën diktaturë, babai nga zonë rurale, bashkëshorti/bashkëshortja (ose bashkëjetuesi/bashkëjetuesja) pa arsim të lartë, babai pa arsim të lartë, nëna nga zonë rurale, numri i familjarëve në shtëpi, apo dhe numri i familjarëve të larguar nga shtëpia – nuk i rrisin gjasat e besimit në ndonjë fe të caktuar, kur këta faktorë analizohen statistikisht në mënyrë simultane me të gjithë faktorët e lartpërmendur.

31. Rezultatet e analizës së regresionit logaritmik rreth gjasave të besimit në një fe të caktuar	
Karakteristikat demografike-arsimore-fetare-ekonomike-politike të të anketuarve	Raporti i gjasave
Arsim fetar	21.59
Nëna beson në një fe të caktuar	6.27
Bashkëshorti/ja (bashkëjetuesi/ja) beson në një fe të caktuar	6.26
Babai beson në një fe të caktuar	4.20
Nëna punonjëse jo e kualifikuar	2.05
Familjarët luteshin fshehtazi kur feja ishte e ndaluar	2.02

Gjinia femërore	1.76
Pa arsim të lartë	1.50
Martuar ose në bashkëjetesë me person të së njëjtës origjinë fetare	1.43
Të ardhurat familjare nën 1000 Euro në muaj	1.32
Lindur në zonë rurale	1.17
Bashkëshorti/ja (bashkëjetuesi/ja) lindur në zonë rurale	1.11
Nëna pa arsim të lartë	1.10
Mosha 65 vjeç e sipër	1.09
Bashkëshorti/ja (bashkëjetuesi/bashkëjetuesja) punonjës jo i kualifikuar	1.07
Mosha 18-39 vjeç	1.06
Babai punonjës jo kualifikuar	0.99
Me banim në fshat	0.99
Familja e përndjekur nën diktaturë	0.98
Babai lindur në zonë rurale	0.98
Bashkëshorti/ja (bashkëjetuesi/ja) pa arsim të lartë	0.97
Babai pa arsim të lartë	0.96
Nëna lindur në zonë rurale	0.96
Numri i familjarëve në shtëpi	0.95
Numri i familjarëve të larguar nga shtëpia	0.95

## PËRMBLEDHJE

Për të kuptuar më qartë rezultatet kryesore statistikore të paraqitura në tabelat e mësipërme, le të bëjmë krahasimin me vende të tjera europiane. Kështu, përqindja e shtetasve shqiptarë të anketuar që besojnë në ndonjë fe të caktuar (59%) është e përafërt me përqindjen e besimtarëve të Europës Perëndimore, domethënë të shteteve ku nuk ka pasur asnjë kufizim ndaj fesë (rreth 60%)<sup>1</sup>, po është më e vogël se përqindja e besimtarëve të shumicës së shteteve të tjera të Europës Lindore, domethënë të vendeve ku nuk u ndalua feja me ligj, por ku shteti ka pasur ndaj fesë pak a shumë të njëjtin qëndrim sikurse regjimi komunist në Shqipëri deri më 1967.<sup>2</sup> Te krahasimi me shtete të tjera do të kthehemi më tej, ndërsa tani le të ndalemi te krahasimi mes tri grupmoshave në Shqipëri.

Së pari, vëmë në dukje se përqindja e besimtarëve të ndonjë feje të caktuar, ndonëse më e madhe ndër të anketuarit e brezit më të vjetër (65.1%), nuk ndryshon shumë nga ajo e brezit të mesëm, e atij që u formua gjatë periudhës së ateizmit shtetëror (56.4%): ndryshimi duket relativisht i vogël në sfondin e veprimeve të shtetit kundër fesë gjatë asaj periudhe. Aq më i vogël është ndryshimi i përqindjes midis brezit më të vjetër dhe atij që u formua mbas viteve 1990 (58.5%).

Një tregues i thellësisë së besimit fetar është ai i frekuentimit të vendeve të kultit (kishë/xhami/teqe/etj.). Në tërësi, 21.7% e të anketuarve shkojnë të paktën një herë në muaj. Sipas grupmoshave, gjithëherë vështruar në sfondin e luftës së shtetit kundër fesë në periudhën e ateizmit shtetëror, brezi i mesëm nuk ndryshon shumë nga pjesa tjetër e të anketuarve në aspektin e frekuentimit të vendeve të kultit jo më pak se një herë në muaj: 19% kundrejt 23.5% të secilit prej dy brezave të tjerë. Ndërkaq, kemi një dallim të spikatur midis brezit më të vjetër dhe dy brezave të tjerë në lidhje me përqindjen e vajtjes në vendet

---

<sup>1</sup> [Attitudes of Christians in Western Europe | Pew Research Center; \[https://www.pewresearch.org/religion/2018/05/29/religious-practice-and-belief/#:~:text=of%20religious%20commitment,-.Few%20people%20in%20Western%20Europe%20attend%20religious%20services%20on%20a,monthly%20\\(22%25%20median\\)\]\(https://www.pewresearch.org/religion/2018/05/29/religious-practice-and-belief/#:~:text=of%20religious%20commitment,-.Few%20people%20in%20Western%20Europe%20attend%20religious%20services%20on%20a,monthly%20\(22%25%20median\)\)](https://www.pewresearch.org/religion/2018/05/29/religious-practice-and-belief/#:~:text=of%20religious%20commitment,-.Few%20people%20in%20Western%20Europe%20attend%20religious%20services%20on%20a,monthly%20(22%25%20median))

<sup>2</sup> <https://www.pewresearch.org/religion/2017/05/10/religious-affiliation/>

e kultit jo më pak se një herë në javë: 14.1% kundrejt 10.7% të brezit të mesmë dhe 9.4% të brezit më të ri. Ata që shkojnë një herë në javë në vendet e kultit mund të konsiderohen thellësisht fetarë. Aktualisht përbëjnë 11.2% të të anketuarve nga të gjithë brezat e shtetasve shqiptarë në moshë madhore. Po të përfshijmë edhe tregues të tjerë, sikurse përgjigjja pozitive ndaj disave prej pyetjeve të anketës – nëse gjërat në botë ndodhin nga vullneti i Zotit, nëse njeriu është krijesë e Zotit, nëse, me vdekjen e njeriut, shpirti i tij vazhdon të jetojë në botën e përtejme, nëse, në varësi të të mirave apo të këqijave që bën njeriu në jetë, shpirti i tij mund të shkojë në Parajsë ose në Ferr, – atëherë në këtë kategori hyjnë vetëm 6.8% e të anketuarve.

Le të kthehemi te krahasimi me shtete të tjera, më specifikisht me dy shtete që, në njëfarë kuptimi, përfaqësojnë dy raste skajshmërisht të përkundra të Europën Perëndimore, por skajshmërisht të ndryshme nga Shqipëria në një vështrim historik të raportit të pushtetit shtetëror me fenë: rasti i Francës, që ka një shtet laik militant, dhe ai i Spanjës, ku katolicizmi ka qenë historikisht fe shtetërore dhe deri përpara më pak se gjysmë shekulli ka qenë komponenti kryesor i ideologjisë së një regjimi diktatorial, madje edhe sot e kësaj dite arsimit është pjesërisht nën kujdestarinë e Kishës. Në këto dy shtete, përqindja e atyre që besojnë në një fe të caktuar është e përafërt me atë të Shqipërisë: 64% në Francë (2018)<sup>3</sup> dhe 58.5% në Spanjë (2024)<sup>4</sup>. Treguesi tjetër që disponojmë nga këto dy shtete për një vështrim krahasues me Shqipërinë është ai i frekuentimit të vendeve të kultit: të paktën një herë në muaj, 22% në Francë dhe 23% në Spanjë<sup>5</sup>, si dhe të paktën një herë në javë, 10.6% në Spanjë<sup>6</sup>. Pra, në të gjithë këta tregues, përqindjet në këto dy shtete janë të përafërta me

---

<sup>3</sup> [Attitudes of Christians in Western Europe | Pew Research Center; https://www.pewresearch.org/religion/2018/05/29/religious-practice-and-belief/#:~:text=of%20religious%20commitment.,Few%20people%20in%20Western%20Europe%20attend%20religious%20services%20on%20a.monthly%20\(22%25%20median\)](https://www.pewresearch.org/religion/2018/05/29/religious-practice-and-belief/#:~:text=of%20religious%20commitment.,Few%20people%20in%20Western%20Europe%20attend%20religious%20services%20on%20a.monthly%20(22%25%20median))

<sup>4</sup> [es3485mar a](https://www.pewresearch.org/religion/2018/05/29/religious-practice-and-belief/#:~:text=of%20religious%20commitment.,Few%20people%20in%20Western%20Europe%20attend%20religious%20services%20on%20a.monthly%20(22%25%20median))

<sup>5</sup> Për të dyja shtetet: [https://www.pewresearch.org/religion/2018/05/29/religious-practice-and-belief/#:~:text=of%20religious%20commitment.,Few%20people%20in%20Western%20Europe%20attend%20religious%20services%20on%20a.monthly%20\(22%25%20median\)](https://www.pewresearch.org/religion/2018/05/29/religious-practice-and-belief/#:~:text=of%20religious%20commitment.,Few%20people%20in%20Western%20Europe%20attend%20religious%20services%20on%20a.monthly%20(22%25%20median))

<sup>6</sup> [chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfindmkaj/https://aelpa.org/web-2018/wp-content/uploads/2021/04/Es3318marMT\\_A.pdf](https://chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfindmkaj/https://aelpa.org/web-2018/wp-content/uploads/2021/04/Es3318marMT_A.pdf)

ato të Shqipërisë. Një tregues ku Shqipëria ndryshon së tepërmi prej tyre, sikurse nga Europa Perëndimore të përgjithësi, është se në Shqipëri, ndër ata që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar, përqindja e ateistëve/agnostikëve është shumë e vogël krahasuar me përqindjen përkatëse në Europën Perëndimore<sup>7</sup>. Për më tepër, në dy shtetet të cilave iu referuam pak më sipër, numri i ateistëve/agnostikëve ka një rritje shumë të shpejtë në dekadat e fundit: në Francë, midis viteve 1990 dhe 2012 është rritur më se tre herë,<sup>8</sup> në Spanjë, është rritur më se 2.5 herë në çerekshkullin e fundit;<sup>9</sup> dhe përbëjnë 30% deri 35% të popullsisë në secilin nga këto dy vende,<sup>10</sup> kundrejt 7.2% në Shqipëri.

Nisur nga krahasimet e mësipërme, si nga ato midis tri grupmohave në Shqipëri, ashtu edhe nga ato midis Shqipërisë dhe shteteve të Europës Perëndimore, mund të themi se ateizmi shtetëror jo vetëm që nuk e arriti qëllimin e çrrënjësjes e fesë, po edhe nuk solli ndonjë ndryshim të madh në këtë drejtim. Kjo konfirmohet edhe me të dhënën statistikore se në pothuaj 40% të familjeve kryheshin fshehurazi rite fetare në periudhën kur kjo dënohej penalisht. Faktorët që sjellin mpakjen e besimit fetar në një shoqëri dhe zbehjen e autoritetit të institucioneve fetare janë të shumëllojshëm dhe pas çdo gjase nuk mund të kenë një emërues të përbashkët. Kjo ide gjen mbështetje edhe te situata e fesë në Europën Lindore. Për shembull, Rumania, ku feja nuk u ndalua me ligj asnjëherë, por që, ndër vendet ish-komuniste europiane, ka pasur në vitet shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë të shekullit të kaluar ngjashmërinë më të madhe me Shqipërinë për nga ashpërsia e diktaturës, ka aktualisht përqindjen më të madhe të besimtarëve në gjithë Europën (99.5%). Republika Çeke, me një regjim diçka më pak të ashpër se Rumania gjatë periudhës komuniste, ka aktualisht përqindjen më të vogël të besimtarëve në gjithë Europën (21.6%). Panorama bëhet edhe më e ndërlikuar po të shohim Sllovakinë, e cila, gjatë pothuajse gjysmë shekulli, ka qenë pjesë e

---

<sup>7</sup> [https://www.pewresearch.org/religion/2018/05/29/religious-practice-and-belief/#:~:text=of%20religious%20commitment-,Few%20people%20in%20Western%20Europe%20attend%20religious%20services%20on%20a,monthly%20\(22%25%20median\)](https://www.pewresearch.org/religion/2018/05/29/religious-practice-and-belief/#:~:text=of%20religious%20commitment-,Few%20people%20in%20Western%20Europe%20attend%20religious%20services%20on%20a,monthly%20(22%25%20median))

<sup>8</sup> [Religion et irrégion. Quels effets sur l'orientation politique et le système de valeurs ? - TRIELEC - WEB Public](#)

<sup>9</sup> [Centro de Investigaciones Sociológicas - CIS](#)

<sup>10</sup> [Religion et irrégion. Quels effets sur l'orientation politique et le système de valeurs ? - TRIELEC - WEB Public; Centro de Investigaciones Sociológicas - CIS](#)



të njëjtit shtet komunist me atë çka sot është Republika Çeke: në Sllovaki, besimtarët përbëjnë 84.2% të popullsisë së vendit.<sup>11</sup>

\*\*\*

Sikurse mund të shihet në tabelat e mësipërme, përpos krahasimit midis grupmoshave në një pjesë të pyetjeve, në pjesën tjetër kemi bërë krahasimin midis besimtarëve në ndonjë fe të caktuar dhe atyre që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar. Te këta të fundit kemi përfshirë edhe ata që besojnë në ekzistencën e Zotit (deistët), edhe ata që nuk besojnë (ateistët dhe agnostikët). Nga përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve, krahasimi mes dy grupeve tregon se qëndrimet që lidhen me besimin fetar kanë një dallim krejt të dukshëm, ndonëse pesha specifike e ateistëve dhe agnostikëve në grupimin e dytë është shumë e vogël. Pra, kjo tregon se, ndër deistët përgjithësisht (më se një e treta e të anketuarve), besimi në ekzistencën e një qenieje të mbinatyrshme nuk është i rëndësishëm në jetën e tyre. Me të vërtetë, siç thotë Blaise Pascal, filozof dhe njëherësh teolog, deizmi është po aq larg besimit fetar sa ateizmi.

\*\*\*

Së fundi, dëshirojmë ta vëmë theksin te dy dukuri gjerësisht të përhapura:

1. Rreth 79% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk do ta kishin problem të martoheshin apo të bashkëjetonin me një person që ka prejardhje fetare të ndryshme nga ajo e tij; ndër besimtarët e ndonjë feje të caktuar, një përgjigje të tillë e kanë dhënë rreth 75% e tyre. Martesat ose bashkëjetesat ndër fetare (për nga prejardhja) përbëjnë 21.6% të numrit të përgjithshëm të martesave/bashkëjetesave. Po t'u shtojmë këtyre të dhënave faktin që mbi një e treta e popullsisë së Shqipërisë përbëhet nga banorë të zonave rurale,

---

<sup>11</sup> [Religious Composition by Country, 2010-2050 | Pew Research Center](#)

domethënë homogjene nga pikëpamja fetare, çka e pakëson mundësinë e zgjedhjes, ato flasin për një tolerancë fetare gjerësisht të përhapur në shoqëri. Për shumicën dërrmuese të të anketuarve, madje edhe për shumicën dërrmuese të atyre që besojnë në ndonjë fe të caktuar, martesë/bashkëjetesa ndërjetare është krejt e pranueshme.

2. Tabelat e mësipërme lidhur me vajtjen në vende kulturi duke shpresuar se kjo ndihmon për problemet shëndetësore apo të tjera jetësore tregojnë se besëtytnia është gjerësisht e përhapur te personat që nuk besojnë në asnjë fe të caktuar. Ndërkaq, prej këtyre tabelave mund të deduktohet gjithashtu se, te personat që besojnë në ndonjë fe të caktuar, besimi fetar është i përzier jo rrallë me besëtytninë, çka është karakteristike për Europën jugore, veçanërisht ndër popullatat rurale ose me prejardhje rurale.

Për besëtytninë, sikurse edhe për thellësinë e besimit fetar, apo edhe për natyrën e deizmit në Shqipëri, mendojmë të kryejmë një studim të hollësishëm në të ardhmen, me intervista të gjata individuale në terren.

## ANEKSI 1

***Bateria e plotë e pyetjeve dhe përgjigjeve, si dhe marzhi i gabimit statistikor për secilën përgjigje (\*Kuotat gjeografike dhe demografike u paracaktuan qysh në kampionim; pra, nuk kanë marzh gabimi statistikor)***

1. Gjinia?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Mashkull	49.6	*
2. Femër	50.4	*
	100.0	

2. Sa vjeç jeni?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. 18-39 vjeç	32.7	*
2. 40-64 vjeç	40.1	*
3. 65 vjeç e sipër	27.2	*
	100.0	
3. Ku keni lindur?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Qytet	56.5	3.0
2. Fshat	43.5	3.0
	100.0	
4. Ku ka lindur babai juaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)

1. Qytet	32.4	2.2
2. Fshat	67.6	2.2
	100.0	
5. Ku ka lindur nëna juaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Qytet	33.4	2.3
2. Fshat	66.6	2.3
	100.0	
6. Ku ka lindur bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja juaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Qytet	39.4	2.7
2. Fshat	39.6	2.7
3. Nuk jam i/e martuar dhe as bashkëjetoj	21.0	1.4
	100.0	

7. Cila është etnia juaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Shqiptare	96.5	0.2
2. Greke	0.9	0.1
3. Arumune	1.9	0.1
4. Maqedonase	0.3	0.0
5. Bullgare	0.1	0.0
6. Tjetër	0.3	0.0
	100.0	
8. Cila është etnia e babait tuaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Shqiptare	96.4	0.2
2. Greke	1.0	0.1
3. Arumune	2.0	0.1
4. Maqedonase	0.3	0.0
5. Bullgare	0.1	0.0
6. Tjetër	0.3	0.0

	100.0	
9. Cila është etnia e nënës suaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Shqiptare	96.0	0.3
2. Greke	1.6	0.1
3. Arumune	1.8	0.1
4. Maqedonase	0.1	0.0
5. Bullgare	0.1	0.0
6. Tjetër	0.5	0.0
	100.0	
10. Cila është apo ka qenë etnia e bashkëshortit/es ose e bashkëjetuesit/es?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Shqiptare	75.6	1.7
2. Greke	1.3	0.1
3. Arumune	1.6	0.1
4. Maqedonase	0.1	0.0
5. Bullgare	0.4	0.0

6. Tjetër		
7. Nuk jam i/e martuar dhe as bashkëjetoj	21.0	1.4
	100.0	
11. Cili është niveli juaj arsimor?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Pa shkollë	0.8	0.1
2. Më pak se shkolla e mesme	31.9	2.2
3. Shkollë e mesme	34.3	2.3
4. Arsimit universitar	22.9	1.6
5. Arsimit pasuniversitar	10.2	0.7
	100.0	
12. A keni arsim fetar?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Jo	98.0	0.1
2. Po, në Shqipëri	1.7	0.1
3. Po, në Turqi	0.1	0.0

4. Po, në Arabi	0.1	0.0
5. Po, diku tjetër		
	100.0	
13. Cili është niveli arsimor i babait tuaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Pa shkollë	7.3	0.5
2. Më pak se shkolla e mesme	46.5	3.2
3. Shkollë e mesme	35.1	2.4
4. Arsimit universitar	10.9	0.7
5. Arsimit pasuniversitar	0.2	0.0
	100.0	
14. Cili është niveli arsimor i nënës suaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Pa shkollë	10.1	0.7
2. Më pak se shkolla e mesme	51.7	3.3
3. Shkollë e mesme	29.4	2.0



4. Arsim universitar	8.1	0.6
5. Arsim pasuniversitar	0.6	0.0
	100.0	
15. Cili është niveli arsimor i bashkëshortit/es ose i bashkjetuesit/es suaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Pa shkollë	0.5	0.0
2. Më pak se shkolla e mesme	24.1	1.6
3. Shkollë e mesme	31.8	2.2
4. Arsim universitar	17.1	1.2
5. Arsim pasuniversitar	5.5	0.4
6. Nuk jam i/e martuar dhe as bashkëjetoj	21.0	1.4
	100.0	
16. Çfarë pune bëni?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Punëtor i thjeshtë jo bujqësor	14.4	1.0
2. Teknik/inxhinier	3.3	0.2

3. Menaxher	3.4	0.2
4. Arsim/shëndetësi	4.1	0.3
5. Nëpunës shteti	10.6	0.7
6. Bujqësi	14.6	0.3
7. I vetëpunësuar	10.2	1.4
8. Pensionist	27.1	1.8
9. Duke kërkuar punë	3.7	0.3
10. Në shtëpi	2.9	0.2
11. Student/nxënës	3.1	0.2
12. Student dhe në punë	2.5	0.2
	100.0	
17. Çfarë pune bën ose ka bërë babai juaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Punëtor i thjeshtë jo bujqësor	32.0	2.2
2. Teknik/inxhinier	8.4	0.6
3. Menaxher	0.3	0.0
4. Arsim/shëndetësi	2.1	0.1
5. Nëpunës shteti	14.6	1.0
6. Bujqësi	23.2	1.6
7. I vetëpunësuar	6.3	0.4
8. Pensionist	12.9	0.9
9. Duke kërkuar punë	0.4	0.0

10. Në shtëpi	0.1	0.0
11. Student		
12. Student dhe në punë		
13. Nuk e di		
	100.0	
18. Çfarë pune bën ose ka bërë nëna juaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Punëtore e thjeshtë jo bujqësore	26.6	1.8
2. Teknike/inxhinierë	0.7	0.0
3. Menaxhere	0.3	0.0
4. Arsimit/shëndetësi	5.7	0.4
5. Nëpunës shtetë	7.3	0.5
6. Bujqësi	24.5	1.7
7. E vetëpunësuar	5.9	0.4
8. Pensioniste	13.1	0.9
9. Duke kërkuar punë	0.3	0.0
10. Në shtëpi	15.4	1.0
11. Studente/nxënëse		
12. Studente dhe në punë		
13. Nuk e di	0.2	0.0
	100.0	

19. Çfarë pune bën ose ka bërë bashkëshorti/ja ose bashkjetuesi/ja juaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Punëtor i thjeshtë jo bujqësor	16.0	1.1
2. Teknik/inxhinier	4.4	0.3
3. Menaxher	3.4	0.2
4. Arsim/shëndetësi	6.8	0.5
5. Punonjës shtetëror	8.1	0.6
6. Bujqësi	9.0	0.6
7. I vetëpunësuar	13.0	0.9
8. Pensionist	12.5	0.9
9. Duke kërkuar punë	1.8	0.1
10. Në shtëpi	3.9	0.3
11. Student/nxënës		
12. Student dhe në punë	0.2	0.0
13. Nuk jam i/e martuar dhe as bashkëjetoj	21.0	1.4
	100.0	
20. Sa pjesëtarë të familjes banojnë në shtëpinë tuaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)

1. Vetëm unë	4.7	0.3
2. Dy	24.5	1.7
3. Tre/katër	47.5	3.2
4. Pesë/gjashtë	21.2	1.4
5. Mbi gjashtë	2.1	0.1
	100.0	
21. Sa pjesëtarë të familjes banojnë në rrethe të tjera ose jashtë vendit?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Asnjë	42.5	2.9
2. Një/dy	37.0	2.5
3. Tre/katër	10.8	0.7
4. Pesë/gjashtë	5.6	0.4
5. Mbi gjashtë	4.0	0.3
	100.0	
22. Sa janë afërsisht të ardhurat mujore të familjes suaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)

1. Deri në 300 Euro	9.2	0.6
2. 300-500 Euro	19.8	1.3
3. 500-750 Euro	17.9	1.2
4. 750-999 Euro	25.7	1.7
5. 1000-1500 Euro	18.0	1.2
6. Mbi 1500 Euro	9.1	0.6
7. (REFUZON)	0.3	0.0
	100.0	
23. Mendoni se gjërat në botë ndodhin nga vullneti i Zotit, apo nga natyra?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Nga Zoti	50.8	3.3
2. Nga natyra	33.0	2.2
3. Jam i/e dyzuar	16.2	1.1
	100.0	
24. Mendoni se njeriu është krijim i Zotit, apo i natyrës?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)

1. I Zotit	70.6	2.0
2. I natyrës	18.7	1.3
3. Jam i/e dyzuar	10.8	0.7
	100.0	
25. A mendoni se, me vdekjen e njeriut, shpirti i tij vazhdon të jetojë në botën e përtejme?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	55.2	3.0
2. Jo	26.4	1.8
3. Jam i/e dyzuar	18.4	1.3
	100.0	
26. A mendoni se, në varësi të të mirave apo të këqijave që bën njeriu në jetë, shpirti i tij mund të shkojë në Parajsë ose në Ferr?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	56.3	3.0
2. Jo	22.6	1.5
3. Jam i/e dyzuar	21.1	1.4

	100.0	
27. A i luteni ndonjëherë Zotit që t'ju ndihmojë në zgjidhjen e problemeve tuaja shëndetësore/jetësore?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	89.2	0.7
2. Jo	10.6	0.7
3. (REFUZON)	0.3	0.0
	100.0	
28. Në qoftë se po, a ju ka ndihmuar Zoti?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
0. (SKIP, nuk i lutem)	10.6	0.7
1. Po	68.7	2.1
2. Jo	7.2	0.5
3. Jam i/e dyzuar	13.2	0.9
4. (REFUZON)	0.4	0.0
	100.0	



29. A mendoni se vajtja në kishë/xhami/teqe/tyrbe etj. mund të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve shëndetësore/jetësore të atyre që shkojnë?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	56.0	3.0
2. Jo	25.7	1.7
3. Jam i/e dyzuar	18.3	1.2
	100.0	
30. A keni shkuar në kishë/xhami/teqe/tyrbe etj. me shpresën kjo mund t'ju ndihmonte në zgjidhjen e problemeve tuaja shëndetësore/jetësore?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	64.0	2.4
2. Jo	35.7	2.4
3. (REFUZON)	0.3	0.0
	100.0	

31. A dini ndonjë rast që vajtja juaj apo e familjarëve/të njohurve tuaj në kishë/xhami/teqe/tyrbe etj. të ketë sjellë zgjidhje problemesh konkrete shëndetësorë/jetësore?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	49.5	3.4
2. Jo	38.1	2.6
3. Jam i/e dyzuar	12.4	0.8
	100.0	
32. Sa shpesh veni në xhami/kishë/teqe/tjetër?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Çdo javë	11.2	0.8
2. Çdo 2 javë	2.5	0.2
3. Çdo muaj	8.0	0.5
4. Më rrallë	22.1	1.5
5. Vetëm për festa fetare	26.7	1.8
6. Vetëm kur kam ndonjë problem shëndetësor/jetësor	4.1	0.3
7. Nuk shkoj fare	25.4	1.7

	100.0	
33. Në qoftë se shkoni në xhami/kishë/teqe/tjetër, kur keni filluar të shkoni?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
0. (SKIP, nuk shkoj)	25.4	1.7
1. Në fëmijëri (1-12 vjeç)	22.0	1.5
2. Adolleshencë (13-19 vjeç)	18.7	1.3
3. Rini (20-29)	14.2	1.0
4. Në moshë "të mesme" (30-50)	17.2	1.2
5. Mbi 50 vjeç	2.5	0.2
6. (Refuzon)	0.1	0.0
	100.0	
34. Në qoftë se shkoni në xhami/kishë/teqe/tjetër, cila ka qenë shtypsa për të shkuar atje fillimisht?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
0. (SKIP, nuk shkoj)	25.4	1.7
1. Familja/fisi	50.0	3.4
2. Shokët/shoqet	16.5	1.1
3. Shkolla fetare	0.6	0.0

4. Interneti	0.4	0.0
5. Leximi i librave	4.3	0.3
6. Tjetër	2.8	0.2
	100.0	
35. A keni vazhduar ju ose prindërit/gjyshërit tuaj t'i kryeni ritet fetare fshehurazi gjatë periudhës që feja ishte e ndaluar në Shqipëri?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	38.7	2.6
2. Jo	50.8	3.3
3. Nuk e di	10.6	0.7
	100.0	
36. A agjëroni gjatë Ramazanit?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Rregullisht	16.4	1.1
2. Herë-herë	21.1	1.4
3. Jo	62.1	2.6

4. (REFUZON)	0.4	0.0
	100.0	
37. A mbani kreshmë gjatë Pashkëve?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Rregullisht	5.8	0.4
2. Herë-herë	8.4	0.6
3. Jo	85.7	1.0
4. (REFUZON)	0.2	0.0
	100.0	
38. A shtroni dreka/darka në familje për festat e mëdha fetare të traditës suaj familjare?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Rregullisht	67.8	2.2
2. Herë-herë	26.5	1.8
3. Jo	5.7	0.4
	100.0	

39. Bazuar vetëm në bindjet tuaja personale (pavarësisht nga prejardhja familjare), a besoni plotësisht në ndonjë fe të caktuar?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Besoj në Zot, por jo në ndonjë fe	33.8	2.3
2. Jam ateist/agnostik	7.2	0.5
3. Tarikati bektashi	5.2	0.4
4. Tarikati rufai/halveti/tjetër	0.5	0.0
5. Dega kryesore myslimane (sunitë)	36.0	2.4
6. I krishterë katolik	7.9	0.5
7. I krishterë ortodoks	8.0	0.5
8. I krishterë protestant/tjetër	1.3	0.1
	100.0	
40. Bazuar vetëm në bindjet e tij personale (pavarësisht nga prejardhja familjare), a beson/te plotësisht babai juaj në ndonjë fe të caktuar?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Beson/te në Zot, por jo në ndonjë fe	29.7	2.0
2. Ateist/agnostik	4.5	0.3
3. Tarikati bektashi	7.4	0.5

4. Tarikati rufai/halveti/tjetër	0.5	0.0
5. Dega kryesore myslimane (sunitë)	39.0	2.6
6. I krishterë katolik	8.4	0.6
7. I krishterë ortodoks	9.6	0.6
8. I krishterë protestant/tjetër	0.3	0.0
9. Nuk e di	0.8	0.1
	100.0	
41. Bazuar vetëm në bindjet e saj personale (pavarësisht nga prejardhja familjare), a beson/te plotësisht nëna juaj në ndonjë fe?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Beson/te në Zot, por jo në ndonjë fe	26.7	1.8
2. Ateiste/agnostike	2.0	0.1
3. Tarikati bektashi	7.1	0.5
4. Tarikati rufai/halveti/tjetër	1.4	0.1
5. Dega kryesore myslimane (sunite)	44.0	3.0
6. E krishterë katolike	8.5	0.6
7. E krishterë ortodokse	9.5	0.6
8. E krishterë protestante/tjetër	0.3	0.0
9. Nuk e di	0.5	0.0
	100.0	

42. Bazuar vetëm në bindjet e tij/e saj personale (pavarësisht nga prejardhja familjare), a beson/te plotësisht bashkshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja juaj në ndonjë fe të caktuar?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Beson/te në Zot, por jo në ndonjë fe	22.8	1.6
2. Ateist/e; agnostik/e	4.3	0.3
3. Tarikati bektashi	5.2	0.4
4. Tarikati rufai/halveti/tjetër	0.3	0.0
5. Dega kryesore myslimane (sunitë)	32.3	2.2
6. I/e krishterë katolik/e	6.5	0.4
7. I/e krishtetë ortodoks/e	6.8	0.5
8. I/e krishterë protestant/e; tjetër	0.8	0.1
9. Nuk jam i/e martuar dhe as bashkëjetoj	21.0	1.4
	100.0	
43. Në qoftë se besoni në një fe të caktuar, a keni plotësisht besim tek udhëheqësit e fesë suaj në Shqipëri?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
0. (SKIP, nuk besoj në ndonjë fe)	41.0	2.8
1. Po	32.0	2.2
2. Jo	14.7	1.0



3. Jam i/e dyzuar	12.2	0.8
4. (REFUZON)	0.1	0.0
	100.0	
44. Në qoftë se besoni në një fe të caktuar, a keni plotësisht besim tek udhëheqës/figura ndërkombëtare të fesë tuaj?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
0. (SKIP, nuk besoj në ndonjë fé)	41.0	2.8
1. Po	29.6	2.0
2. Jo	15.2	1.0
3. Jam i/e dyzuar	13.9	0.9
4. (REFUZON)	0.3	0.0
	100.0	
45. A lexoni/keni lexuar libra të shenjtë, si Bibla, Kurani, etj.?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Shpesh	17.7	1.2
2. Rrallë	37.8	2.6
3. Jo	44.5	3.0

	100.0	
46. A dini ndonjë rast që përkatësitë e ndryshme fetare të kenë krijuar konflikte në rrethin tuaj familjar apo shoqëror?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	7.2	0.5
2. Jo	92.7	0.5
3. (REFUZON)	0.1	0.0
	100.0	
47. A mendoni se ekstremizmi i disa besimtarëve të një feje të caktuar mund të shkaktojë në të ardhmen incidente terroriste këtu në Shqipëri?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	36.0	2.4
2. Jo	46.2	3.1
3. Jam i/e dyzuar	17.8	1.2
	100.0	

48. A mendoni se përkatësitë e ndryshme fetare mund të krijojnë konflikte në shoqërinë shqiptare në të ardhmen?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	23.6	1.6
2. Jo	63.3	2.5
3. Jam i/e dyzuar	13.2	0.9
	100.0	
49. Si mendoni, a ka ndikuar për mirë apo për keq në shoqërinë shqiptare ndalimi ligjërisht i feve nga shteti shqiptar në periudhën 1967-1990?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Për mirë	9.6	0.6
2. Për keq	60.4	2.7
3. Jam i/e dyzuar	17.1	1.2
4. Nuk kam njohuri të mjaftueshme	13.0	0.9
	100.0	

50. Pavarësisht nëse besoni apo nuk besoni realisht në ndonjë fe të caktuar, po të bazoheni vetëm në origjinën tuaj familjare, cilës fe i përkisni tradicionalisht?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Tarikati bektashi	12.6	0.8
2. Tarikati rufai/halveti/tjetër	0.6	0.0
3. Dega kryesore mysliman (sunitë)	60.9	2.7
4. I krishterë katolik	11.5	0.8
5. I krishterë ortodoks	14.3	1.0
6. Tjetër	0.1	0.0
	100.0	
51. Pavarësisht nëse babai juaj beson/te apo nuk beson/te realisht në ndonjë fe të caktuar, po të bazoheni vetëm në traditën e tij familjare, cilës fe i përket/iste tradicionalisht?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Tarikati bektashi	13.6	0.9
2. Tarikati rufai/halveti/tjetër	0.5	0.0
3. Dega kryesore myslimane (sunit)	60.5	2.7
4. I krishterë katolik	11.0	0.7
5. I krishterë ortodoks	14.1	1.0

6. Tjetër	0.1	0.0
7. Nuk e di	0.2	0.0
	100.0	
52. Pavarësisht nëse nëna juaj beson/te apo nuk beson/te realisht në ndonjë fe të caktuar, po të bazoheni vetëm në origjinën e saj familjare, cilës fe i përket/iste tradicionalisht?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Tarikati bektashi	11.2	0.8
2. Tarikati rufai/halveti/tjetër	1.2	0.1
3. Dega kryesore myslimane (sunite)	62.2	2.6
4. E krishterë katolike	9.8	0.7
5. E krishterë ortodokse	14.5	1.0
6. Tjetër	0.1	0.0
7. Nuk e di	0.7	0.0
8. (REFUZON)	0.4	0.0
	100.0	

53. Pavarësisht nëse bashkëshorti/ja juaj apo bashkëjetuesi/ja juaj beson/te apo nuk beson/te realisht në ndonjë fe të caktuar, po të bazoheni vetëm në origjinën e tij/e saj familjare, cilës fe i përket/iste tradicionalisht?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Tarikati bektashi	10.0	0.7
2. Tarikati rufai/halveti/tjetër	0.2	0.0
3. Dega kryesore myslimane (sunitë)	47.9	3.2
4. I/e krishterë katolik/e	8.4	0.6
5. I/e krishterë ortodoks/e	12.0	0.8
6. Tjetër	0.1	0.1
7. Nuk jam i/e martuar dhe as bashkëjetoj	21.0	1.4
8. (REFUZON)	0.3	0.0
	100.0	
54. A e keni problem nëse një pjesëtar i familjes suaj (përfshirë veten) martohet me dikë nga një familje me prejardhje fetare të njëjtë, por me denominacion të ndryshëm (p.sh. martesë bektashi/e me sunit/e ose martesë ortodoks/e me katolik/e)?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	7.8	0.5
2. Jo	87.2	0.9

3. Jam i/e dyzuar	5.1	0.3
	100.0	
55. A e keni problem nëse një pjesëtar i familjes tuaj (përfshirë veten) martohet me dikë nga një familje me prejardhje fetare të ndryshme nga juaja (konkretisht, mysliman/e me të krishterë)?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Po	12.5	0.8
2. Jo	79.2	1.4
3. Jam i/e dyzuar	8.3	0.6
	100.0	
56. Si ka qenë situata politike e familjes suaj para vitit 1990?	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Në pozita të mira	30.5	2.1
2. As mirë, as keq	50.1	3.4
3. E përndjekur	17.8	1.2
4. Nuk e di	1.6	0.1

	100.0	
57. Zona ku u krye kjo intervistë	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Urbane	65.8	*
2. Rurale	34.2	*
	100.0	
58. Qarku në të cilin u krye kjo intervistë	Përqind	Marzhi i gabimit statistikor (+/-)
1. Berat	5.9	*
2. Dibër	4.5	*
3. Durrës	9.4	*
4. Elbasan	9.7	*
5. Fier	10.0	*
6. Gjirokastrë	2.5	*
7. Korçë	7.2	*
8. Kukës	2.6	*



9. Lezhë	4.1	*
10. Shkodër	6.4	*
11. Tiranë	31.6	*
12. Vlorë	6.1	*
	100.0	

## ANEKSI 2

### *Metodologjia*

Për këtë studim statistikor është përdorur një kampion i shtresëzuar prej 820 të anketuarish të moshave 18 vjeç e sipër. Në shtresën e parë, anketat u shpërndanë proporcionalisht mes 12 qarqeve të Shqipërisë, bazuar në popullsinë e tyre të rritur. Në shtresën e dytë, anketat u shpërndanë proporcionalisht mes zonave urbane/periferike dhe rurale brenda çdo qarku, për të pasqyruar shpërndarjen gjeografike. Në mënyrë të ngjashme u caktuan edhe kuotat e moshës e të gjinisë për çdonjërin nga shtresat. Së fundi, pikat e anketimit u përzgjedhën rastësisht nga harta digjitale e Shqipërisë për intervistat, sipas skemës së mësipërme të kampionimit. Qëllimi i kësaj qasjeje të shtresëzuar ishte arritja e një përfaqësimi sa më të saktë gjeografik dhe demografik të popullsisë së rritur të Shqipërisë, duke siguruar një marzh gabimi statistikor nga +/- 0.01% deri në +/- 3.3% në shkallë vendi. Ky kampionim i rastësishëm e i shtresëzuar siguron që çdo banor në Shqipëri të ketë një probabilitet të barabartë përzgjedhjeje për anketim. Duke u përdorur kjo metodë kampionimi, rezultatet pasqyrojnë opinionet dhe perceptimet e popullsisë së rritur në Shqipëri me përafërsinë më të madhe të mundshme.